

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7996
E enjte, 20 shkurt 2025
Çmimi 0.50 €

Dhjetë ditë pas zgjedhjeve, vazhdon numërimi i votave për deputetë | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ISH-PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, PËR ARSYE SHËNDETËSORE AS TË MËRKURËN NUK ËSHTË PARAQITUR NË SEANCËN E CILA PO MBAHET PËR ECURINË E ÇËSHTJES NË RASTIN E ISH-KRERËVE TË UÇK-SË | FAQE 4-5

OVLUÇK-ja KËRKON NGA GJYKATA SPECIALE RAPORT PËR GJENDJEN SHËNDETËSORE TË THAÇIT

ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

REAGIM

Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shpreh shqetësimin e saj të thellë për gjendjen shëndetësore të bashkëluftëtarit të saj, ish presidentit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi.

Jemi të indinjuar me heqjen e institucioneve të Kosovës, të cilat jo vetëm që nuk po reagojnë ndaj padrejtësive të Gjykatës Speciale, por as nuk po e mbajnë operacionin politik të informuar mbi gjendjen e tyre shëndetësore.

Kërkuesit nga Gjykata Speciale që të japin një raport të qartë dhe zyrtar mbi gjendjen shëndetësore të ish-presidentit Thaçi dhe bashkëluftëtarëve tani, që po mbahen përkrahurit të parashfaqur që atëherë tani.

Për ne është e pyetjeve që informacioni mbi shëndetin e tyre, të mbetur në duart e specialëve nga individë dëshmorë, të cilët nuk ishin të mirë Kosovës, as luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Institucionet e Kosovës duhet të marrin përgjegjësi të tyre dhe të angazhohen për monitorimin e procesit gjyqësor. Nuk do të pësojmë neglizhencë dhe heqjen institucionale, që po shprehin padrejtësi që po i bëhet nga Gjykata Speciale bashkëluftëtarëve tanë të Thaçi.

Informimi i qytetarëve dhe garantimi i tërësisht të duhur të të parashfaqurve që janë me nevojë për shëndet dhe kështu të shprehin informacione dhe kërkuesit që ky detyrim të përmbushet menjëherë.

Liria dhe drejtësia nuk mund të shprehin mbi heqjen, neglizhencë dhe padrejtësi që po i bëhet bashkëluftëtarëve tanë të Thaçi, nga Gjykata Speciale.



Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka shprehur shqetësimin e saj për gjendjen shëndetësore të ish-presidentit Hashim Thaçi. Në reagimin për medie thuhet se është e

indinjuar me heshtjen e institucioneve të Kosovës, të cilat, sipas saj, nuk po reagojnë ndaj padrejtësive të Gjykatës Speciale. "Kërkojmë nga Gjykata Speciale që të japë një raport të qartë dhe zyrtar mbi

gjendjen shëndetësore të ish-presidentit Thaçi dhe bashkëluftëtarëve tanë që po mbahen padrejtësisht në paraburgim që mbi katër vjet", është thënë në reagimin e OVLUÇK-së

PROKURORIA I KËRKON GJYKATËS TA URDHËROJË KURTIN TË PARAQITET DËSHMITAR NË RASTIN E REZERVAVE F.3



PARLAMENTI EVROPIAN KËRKON HEQJEN E MASAVE NDËSHKUESE NDAJ KOSOVËS F.4



KOSOVA DHE SHQIPËRIA FILLOJNË AUDITIMIN PARALEL "MBROJTJA DHE SIGURIA E DIGAVE" F.8

'INDEPENDENT': SHQIPËRIA, NDËR DESTINACIONET MË TË BUKURA PËR T'U VIZITUAR MË 2025 F.8

SPORT



KOSOVA KËRKON FITORE NDAJ AZERBAJXHANIT F.10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky thotë se Trumpi ka ngecur në një “hapësirë dezinformimi”

KIEV, 19 SHKURT - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, tha të mërkurën se presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka ngecur në një “hapësirë dezinformimi” dhe hodhi poshtë një pretendim të presidentit amerikan se popullariteti i Zelenskyt ishte vetëm 4 për qind.

Zelensky, i cili thuhet se ka përkrahje prej 57-përqindësh të popullsisë sipas një sondazhi të një institucioni kërkimor në Kiev, tha se përpjekjet për ta zëvendësuar atë nuk do të funksiononin, një ditë pasi Trumpi tha se Ukraina duhet të mbajë zgjedhje.

Lideri ukrainas, në komentet e tij të para si përgjigje ndaj Trumpit, tha se presidenti amerikan po përsëriste dezinformata, të cilat, sipas tij, vinin nga Moskë. “Duke qenë se po flasim për 4 për qind... E kemi parë këtë dezinformim, e

kuptojmë që vjen nga Rusia”, tha Zelensky në një konferencë shtypi të transmetuar në televizionin shtetëror ukrainas. “Presidenti Trump, për fat të keq, jeton në këtë hapësirë dezinformimi”, shtoi ai.

Një natë më parë Trumpi kishte lënë të kuptohet se ai e fajëson Ukrainën për nisjen e luftës. “Nuk duhet ta kishit nisur kurrë. Mund të kishit bërë një marrëveshje”, tha Trump. Ai nuk e sqaroi se çfarë nënkuptonte me këtë, por shpesh ka lënë të kuptohet se lufta filloi për shkak të dëshirës së Ukrainës për t'u anëtarësuar në NATO.

Ekspertët thonë se pushtimi i plotë nga Rusia u nxit nga ambiciet imperialiste të Putinit dhe jo nga aspirata e Ukrainës për NATO, e cila kishte pak mbështetje nga Perëndimi në atë kohë.

Trumpi tha se Ukraina duhet



të mbajë zgjedhje, duke shtuar: “Kjo nuk është diçka që vjen nga Rusia, por nga unë dhe nga shumë vende të tjera”. Trumpi e kishte bërë atë koment pas përfundimit të bisedimeve në Riad midis sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio, dhe zyrtarëve të tjerë amerikanë, si dhe një delegacioni rus të udhëhequr nga ministri i Jashtëm, Sergei

Lavrov. Zelensky tha të mërkurën se rezultati i negociatave midis përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë në kryeqytetin saudit, Riad, ishte heqja e izolimit ndërkombëtar të liderit rus, Vladimir Putin. “Mendoj se Putini dhe rusët janë shumë të lumtur, sepse çështja po diskutohet me ta si një ‘viktimitë’, kjo është diçka e re”,

tha Zelensky në një konferencë shtypi në Kiev më 19 shkurt.

Në bisedimet në Riad, që ishin takimet e para zyrtare të nivelit të lartë midis Uashingtonit dhe Moskës që nga pushtimi i vitit 2022, Rusia dhe Shtetet e Bashkuara ranë dakord të krijojnë ekupe negociuese për të gjetur një rrugë për t'i dhënë fund luftës “sa më shpejt të jetë e mundur”, tha Rubio.

Rubio theksoi nevojën për përmirësime në ambasadat e ShBA-së dhe Rusisë për të krijuar misione që mbështesin bisedimet e paqes, marrëdhëniet dypalëshe dhe bashkëpunimin në një kuptim më të gjerë.

Disa liderë evropianë, të alarmuar nga ndryshimi radikal në politikën e ShBA-së ndaj Rusisë, kanë frikë se Uashingtoni do të bëjë lëshime serioze dhe do ta rishkruajë strukturën e sigurisë së kontinentit.

Prokuroria kërkon pesë vjet burgim për Dodikun dhe ndalimin e veprimtarisë politike për 10 vjet

SARAJEVË, 19 SHKURT - Prokuroria e Bosnjë-Hercegovinës, në seancën përfundimtare më 19 shkurt, kërkoi nga Gjykata e Bosnjë-Hercegovinës që t'i shqiptojë një dënim me pesë vjet burgim presidentit të Republikës Sërpska, Millorad Dodik, dhe t'ia ndalojë atij veprimtarinë politike për dhjetë vjet.

Të njëjtin dënim maksimal prokurorët e kërkuan edhe për Millosh Llukiqin, ushtrues detyre i drejtorit të Gazetës Zyrtare të Republikës Sërpska. Ata akuzohen për mosrespektim të vendimeve të përfaqësuesit të Lartë, Christian Schmidt, dhe rrezikojnë të dënohen me burgim deri në pesë vjet dhe ndalim të veprimtarisë politike.

Dodikun akuzohet për



nënshkrimin e dekreteve presidenciale, me të cilat shpalli të vlefshëm dy ligje

Ndërkaq Llukiqi akuzohet për publikimin e këtyre ligjeve dhe dekreteve të cilat parashikojnë se vendimet e përfaqësuesit të lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjë-Hercegovinës nuk do të zbatohen në atë entitet.

Mbrojtja e Dodikut dhe Llukiqit në fjalën përfundimtare deklaruan se vepra penale për të cilën janë akuzuar “nuk ka pasoja ligjore apo çfarëdo pasoje tjetër”, pasi përfaqësuesi i lartë i ka anuluar të dyja ligjet dhe se për këtë arsye “nuk ka as vepër penale”.

Ata kujtuan se Dodiku kishte nënshkruar dekrete për shpalljen e dy ligjeve, ndërsa Llukiqi kishte urdhëruar publikimin e tyre para se vendimet e përfaqësuesit të Lartë, me të cilat këto ligje u

anuluan, të publikoheshin në Gazetën Zyrtare të Bosnjë-Hercegovinës dhe të hynin në fuqi.

Mbrojtja argumentoi se nëse Dodiku dhe Llukiqi do të kishin refuzuar të nënshkruanin dhe publikonin dekrete, ata do të kishin shkelur Kushtetutën dhe ligjet e Republikës Sërpska dhe në atë rast do të përballeshin me dënim me burgim deri në 12 vjet. Në fjalën përfundimtare procesin ata e cilësuan sërish si “politik” dhe “nën ndikimin e të huajve”, ndërsa Christian Schmidtin e quajtën “përfaqësues të lartë jolegjitim”, duke përsëritur tezat e vjetra se ai nuk është konfirmuar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ashtu siç janë konfirmuar përfaqësuesit e mëparshëm.

Putini thotë se i vlerëson “lart” bisedimet ShBA - Rusi

MOSKË, 19 SHKURT - Presidenti rus Vladimir Putin tha se i vlerëson “lart” bisedimet mes Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë që u mbajtën më 18 shkurt në Riad të Arabisë Saudite.

Udhëheqësi rus tha se bisedimet ishin “hapi i parë” drejt rivendosjes së raporteve mes Moskës dhe Uashingtonit. “Jam informuar [për bisedimet]. I

vlerësoj lart. Ka rezultate”, tha Putini gjatë një ngjarjeje në Shën Petersburg. “Për mendimin tim, ne kemi bërë hapin e parë për ta rinisur punën në disa fusha të interesit të përbashkët”, shtoi Putini. Udhëheqësi rus tha se shteti i tij ka nevojë ta ndërtojë besimin me ShBA-në në mënyrë që të zgjidhet konflikti në Ukrainë. “Është e pamundur të zgjidhen

shumë çështje, përfshirë kriza ukrainase, pa rritur nivelin e besimit mes Rusisë dhe ShBA-së”, tha Putini. Pas bisedimeve në Riad, Departamenti Amerikan i Shtetit tha se Uashingtoni dhe Moskë janë pajtuar për t'i adresuar faktorët “acarues” në raportet mes dy shteteve dhe kanë nisur punën drejt dhënies fund të luftës në Ukrainë.



ISH-PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, PËR ARSYE SHËNDETËSORE AS TË MËRKURËN NUK ËSHTË PARAQITUR NË SEANCËN E CILA PO MBAHET PËR ECURINË E ÇËSHTJES NË RASTIN E ISH-KRERËVE TË UÇK-së

OVLUÇK-ja kërkon nga Gjykata Speciale raport për gjendjen shëndetësore të Thaçit

Organizata e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka shprehur shqetësimin e saj për gjendjen shëndetësore të ish-presidentit Hashim Thaçi. Në reagimin për medie thuhet se është e indinjuar me heshtjen e institucioneve të Kosovës, të cilat, sipas saj, nuk po reagojnë ndaj padrejtësive të Gjykatës Speciale.

“Kërkojmë nga Gjykata Speciale që të japë një raport të qartë dhe zyrtar mbi gjendjen shëndetësore të ish-presidentit Thaçi dhe bashkëluftëtarëve tanë që po mbahen padrejtësisht në paraburgim që mbi katër vjet”, është thënë në reagimin e OVLUÇK-së



jep leje që të vazhdojmë pa praninë e tij”, ka thënë të martën gjyqtari Smith. Ish-këshilltari i Thaçit, Artan Behrami, i cili në zgjedhjet e 9 shkurtit ka arritur të sigurojë votat e mjaftueshme për deputet të Kuvendit të Kosovës, ka thënë se sapo të krijohen institucionet e Kosovës, qysh në ditën e parë, bashkë me ShBA-në duhet ta fillojnë procesin për t'i larguar duart politike të Jack Smithit

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ


PRISHTINË, 19 SHKURT - Organizata e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare ka shprehur shqetësimin saj të thellë për gjendjen shëndetësore të bashkëluftëtarit të saj, ish-presidentit Hashim Thaçi. Në reagimin e kësaj organizate kërkohet nga Gjykata Speciale që të japë një raport të qartë dhe zyrtar mbi gjendjen shëndetësore të ish-presidentit Thaçi. “Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës shpreh shqetësimin e saj të thellë për gjendjen shëndetësore të bashkëluftëtarit të saj, ish-presidentit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi. Jemi të indinjuar me heshtjen

e institucioneve të Kosovës të cilat jo vetëm që nuk po reagojnë ndaj padrejtësive të Gjykatës Speciale, por as nuk po e mbajnë opinionin publik të informuar mbi gjendjen e tyre shëndetësore. Kërkojmë nga Gjykata Speciale që të japë një raport të qartë dhe zyrtar mbi gjendjen shëndetësore të ish-presidentit Thaçi dhe bashkëluftëtarëve tanë që po mbahen padrejtësisht në paraburgim që mbi katër vjet. Për ne është e papranueshme që informatat mbi shëndetin e tyre, të mbeten në duart e spekulimeve nga individë dashakeq, të cilët nuk ia duan të mirën Kosovës, as luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, thuhet në reagimin e OVLUÇK-së. Më tutje theksohet se institucionet e Kosovës duhet

t'i marrin përgjegjësitë e tyre dhe të angazhohen për përcjelljen e procesit gjyqësor. “Nuk do të pranojmë neglizhencën dhe heshtjen institucionale, që po ndodh ndaj padrejtësive që po u bëhet nga Gjykata Speciale bashkëluftëtarëve tanë në Hagë. Informimi i qytetarëve dhe garantimi i trajtimit të duhur të të paraburgosurve që janë me meritoret për shtetin që kemi sot, është detyrim i institucioneve dhe kërkojmë që ky detyrim të përmbushet menjëherë. Liria dhe drejtësia nuk mund të ndërtohen mbi heshtjen, neglizhencën dhe padrejtësitë që po u bëhen bashkëluftëtarëve tanë në Hagë, nga Gjykata Speciale”, thuhet në reagimin e OVLUÇK-së. Të martën dhe të mërkurën Thaçi nuk ishte i pranishëm në seancë në Hagë për shkak

se kishte përkeqësim të gjendjes shëndetësore. Avokati i Thaçit, Luka Misiq, të martën tha se sekretarja e kishte njoftuar se klienti i tij nuk ndihej mirë me shëndet. “As unë nuk kam informacion. Sekretarja më njoftoi se klienti nuk ndihej mirë dhe nuk mund të merrte pjesë në seancën e sotme. Nuk jam konsultuar fare me klientin lidhur me këtë. Mendova se ishte zgjidhur prej jush”, kishte thënë Misiq. Hollësi për këtë rast kishte dhënë edhe gjyqtari i rastit. Ai tregoi se Thaçi ka pasur nevojë të konsultohet me një mjek. “I vetmi komunikim ishte se nuk ka qenë mirë nga shëndeti, dhe duhet të fliste me një mjek. Komunikoni me të nëse

nga Gjykata Speciale. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi ndodhen në paraburgim që prej vitit 2020. Në procesin gjyqësor që ka nisur më 3 prill 2023, ish-drejtuësit e UÇK-së janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës.



ZPS: Më 4 prill përfundojnë dëshmitë ndaj ish-krerëve të UÇK-së

Hagë, 19 shkurt - Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Hagë ka njoftuar se nuk do të thërrasë asnjë dëshmitar pas 4 prillit në rastin e gjykimit të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Këtë e konfirmoi prokurori Matt Mallng në një konferencë të mbajtur më 19 shkurt për ecurinë e rastit, ku tha se “4 prilli është data e fundit e dëshmitarëve. Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ish-deputeti Rexhep Selimi dhe dy ish-kryetarët e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ata gjenden në qendrën e paraburgimit në Hagë që katër vjet dhe vazhdimisht kërkesat e tyre për lirim nga paraburgimi janë refuzuar nga gjykatësit.



Gjatë konferencës u bë me dije se gjatë javës së ardhshme do të dëshmojnë edhe dy dëshmitarë të tjerë, ndërsa për muajin mars u tha se deri më tani është konfirmuar vetëm dëshmia e një personi, me gjithë planet për të intervistuar edhe dëshmitarë të tjerë. Në prill, pasi ZPS-ja ta ketë përfunduar marrjen në pyetje

të dëshmitarëve, ekipet mbrojtëse të katër të pandehurve, të cilët janë deklaruar të pafajshëm, do ta paraqesin rastin e tyre. Në konferencën e sotme nuk mori pjesë Thaçi, ngjashëm si në atë të fundit, për shkak shëndetësor. Tre të akuzuarit e tjerë ishin të pranishëm përmes një video-lidhjeje. Gjykimi ndaj tyre nisi në prill

të vitit 2023, teksa ekipet mbrojtëse vazhdimisht janë ankuar për kohëzgjatjen e këtij procesi. Në nëntor të vitit të kaluar kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës, Ekaterina Trendafilova, kishte thënë se u takon gjykatësve që të vendosin nëse do t'i lirojnë në paraburgimi katër ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kur Prokuroria e Specializuar ta përfundojë rastin e saj. Zyra e Prokurorit të Specializuar kishte konfirmuar aktakuzën ndaj ish-krerëve të UÇK-së në tetor të vitit 2020, por e bëri publike vetëm një muaj më vonë. Aktakuza i ngarkon të akuzuarit për përgjegjësi “personale”, por edhe për “krimet e kryera nga vartësit e tyre”. Aktakuza thotë se katër të akuzuarit dhe anëtarë të tjerë


të UÇK-së ishin pjesë e një “ndërmarrjeje të përbashkët kriminale” dhe “kanë ndarë qëllimin e njëjtë për të marrë dhe ushtruar kontrollin në gjithë Kosovën me të gjitha mjetet, përfshirë edhe frikësimin, keqtrajtimin, ushtrimin e dhunës dhe eliminimin e atyre që i konsideronin kundërshtarë”. Gjykata Speciale apo Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. Gjykata është themeluar në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por vepron me personel ndërkombëtar dhe ka selinë në Hagë.

Dhjetë ditë pas zgjedhjeve, vazhdon numërimi i votave për deputetë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 SHKURT - Kanë kaluar dhjetë ditë që nga mbajtja e zgjedhjeve parlamentare, por ende nuk ka rezultat përfundimtar për partitë dhe deputetët. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po vazhdon procesin e numërimit të votave për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Deri tani votat për kandidatët për deputetë janë numëruar në rreth 88 % të vendvotimeve, madje janë publikuar edhe disa lista me numrat e votave të grumbulluara nga kandidatët e partive politike që kanë kaluar pragun zgjedhor. Megjithatë, zyrtarët e KQZ-së nuk kanë dhënë një datë të saktë se kur mund të përfundojë numërimi, por besojnë se procesi do të përmbyllet brenda pak ditësh.

Një ditë më parë kryesuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kreshnik Radoniqi, ka pritur në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves. Në këtë takim kryesuesi Radoniqi e informoi ambasadorin Hargreaves lidhur me aktivitetet që aktualisht është duke i zhvilluar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Radoniqi e njoftoi ambasadorin britanik se KQZ-ja në Qendrat Komunale të Numërimit është duke bërë numërimin e votave të kandidatëve për deputetë dhe se në pjesën më të madhe të komunave ky proces ka përfunduar. Gjithashtu, Radoniqi e informoi ambasadorin britanik edhe për



proceset e tjera që po kryhen nga KQZ-ja, siç është vlerësimi i pakove me fletëvotime nga votimi jashtë Kosovës, respektivisht votimi përmes postës.

Nga ana e tij, ambasadori Hargreaves e përgëzoi KQZ-në për procesin e suksesshëm dhe të qetë të 9 shkurtit si dhe vlerësoi përpjekjet e KQZ-së që procesi në vazhdim të realizohet sa më shpejt dhe me transparencë.

Në zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit, sipas rezultateve preliminare, LV-ja ka dalë e para me 40.84 për qind të votave, pasuar nga PDK-ja me 22.5 për qind, LDK-ja me 17.67 për qind dhe koalicioni AAK-Nisma me 7.45

për qind.

Asnjëra parti nuk i ka siguruar votat e nevojshme për ta formuar qeverinë, pasi nevojiten votat e 61 deputetëve në Kuvendin prej 120 ulësesh, prandaj njohësit e çështjeve politike kanë paralajmëruar se Kosova mund të përballet me turbulenca politike në ditët dhe javët në vijim.

Partitë opozitare, PDK-ja dhe AAK-ja, kanë thënë se pëlqejnë të bashkëpunojnë me partitë që aktualisht janë në opozitë për ta formuar ekzekutivin e ri, ndërsa LDK-ja ka thënë se pret numërimin përfundimtar të votave për t'i ofruar qëndrimet e veta politike.

Aktualisht janë duke u numëruar votat për kandidatët

për deputetë, ndërsa më pas pritet të numërohen votat me kusht, të personave me nevoja të veçanta dhe votat nga diaspora.

Ambasadorët nga disa shtete të Quintit dhe i dërguari evropian në Kosovë kanë zhvilluar të hënën takime të ndara me liderët e partive politike në Kosovë. Temë e diskutimeve kanë qenë hapat e ardhshëm pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit. Mesazhi i ambasadorëve të huaj ishte se qeveria e re duhet t'i ndjekë reformat për t'iu bashkuar BE-së. Ndërsa liderët politikë kanë theksuar se presin që Komisioni Qendror Zgjedhor ta mbyllë sa më shpejt procesin e numërimit dhe certifikimit të rezultateve.

Kryeziu: Sistemi aktual zgjedhor favorizon lojalitetin dhe strukturën partiake

Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se sistemi aktual zgjedhor favorizon lojalitetin dhe strukturën partiake, ku shumë deputetë mbështeten nga makineria e partisë për të siguruar vota. Ai ka shtuar se përbërja e Kuvendit, me disa përjashtime, është kryesisht rezultat i këtyre strukturave. "Nëse Kosova do të kishte një sistem zgjedhor me shumë zona, përbërja e parlamentit dhe dinamika e partive politike do të ndryshonin ndjeshëm. Një model i kombinuar mazhoritar-proporcional, i ndarë në 28 zona zgjedhore, do të siguronte përfaqësim më të drejtë dhe më të balancuar gjeografikisht, cilësi më të lartë të përfaqësimit, më shumë llogaridhënie dhe një lidhje më të afërt midis deputetëve dhe qytetarëve. Nëse nuk jeni të kënaqur me përfaqësimin politik dhe mënyrën se si funksionon politika në Kosovë, këtë mund ta ndryshojmë vetëm përmes reformimit të sistemit zgjedhor", ka thënë Kryeziu.

"Trupat amerikane mund të largohen nga Kosova", shkruan "Bild"

Prishtinë, 19 shkurt - Ekziston një shqetësim i madh në shumë pjesë të Evropës për negociatat ShBA - Rusi edhe pse presidenti amerikan Donald Trump (78) përjashtoi një tërheqje të plotë të trupave amerikane nga Evropa. Kështu shkruan mediumi prestigjioz gjerman "Bild", sipas informacioneve të të cilit, shërbimet perëndimore të sigurisë dhe politikanët kanë frikë se negociatat mund të çojnë në përfundimin e pranisë së trupave amerikane në pjesë të mëdha të Evropës. Në këtë kontekst, shkruan "Bild", një zyrtar i sigurisë së Evropës tha: "Sipas informacioneve tona, bëhet fjalë për kërkesat e (Vladimir) Putinit të vitit 2021, pra tërheqjen e trupave amerikane nga të gjitha shtetet

e NATO-s që iu bashkuan aleancës pas vitit 1990".

Siç thekson mediumi gjerman, një skenar i rastit më të keq të cilit shumë ekspertë i druhen është ai i një pushtimi të menjëhershëm nga ushtria ruse i ish-republikave sovjetike të Estonisë, Letonisë dhe Lituanisë, si dhe një luftë në shkallë të gjerë me Poloninë.

Ish-ministri i Jashtëm i Lituanisë, Gabrielius Landsbergis, gjithashtu shpjegoi për X: "(Sergei) Lavrov kërkoi që NATO të kthehej në kufijtë e saj të vitit 1997 dhe të tërhiqej nga të gjitha vendet përveç Gjermanisë Lindore në interes të stabilitetit në Evropë. Pra, pse të mos e kërkojë Putini këtë në Riad?".

Madje, sipas informacioneve të "Bild"-it, Italia po përgatitet



edhe për një tërheqje të mundshme të trupave amerikane nga Kosova. "Atëherë aleatët evropianë do të ishin të vetëm në Ballkan kundër mikut të Putinit,

Aleksandar Vuçiq dhe ushtrisë së tij të fuqishme serbe", thekson "Bild"-i, transmeton "Telegrafi".

Në pjesën e fundit të shkrimit, mediumi gjerman sjell edhe një

analizë të "Financial Times", sipas së cilës: "Putini dëshiron që trupat e NATO-s të tërhiqen nga e gjithë ish-perandoria sovjetike. Zyrtarët evropianë besojnë se ka të ngjarë që Trumpi të pranojë t'i tërheqë trupat amerikane nga Baltiku dhe, ndoshta, më në perëndim. Kjo do ta linte BE-në të pambrojtur kundër një ushtrie ruse".

Sipas informacioneve të "Bild"-it, aktualisht nuk janë në diskutim vetëm bazat amerikane në Ramstein të Gjermanisë dhe bazat e forcave ajrore në Britaninë e Madhe. Kështu, në pah mediumi gjerman, pjesa tjetër e Evropës duhet të përgatitet për ndryshime të thella nëse Trumpi dhe Putini arrijnë një marrëveshje.

KMDLNj-ja kërkon nga Maqedonia e Veriut ta lirojë ish-ushtarin e UÇK-së, Emin Bajrami

PRISHTINË, 19 SHKURT - Më 14 shkurt, në orën 14:10, në pikëkalimin e Bllacës, policia e Maqedonisë së Veriut arrestoi ish-ushtarin e UÇK-së, Emin Bajrami, i lindur në fshatin Kashtanjevë, komuna e Shtërpçës, me banim të përhershëm në fshatin Greme, Ferizaj. Më 15.02. 2025 gjykatësja e procedurës paraprake në Shkup, Sandra Krstiq, i caktoi masën e paraburgimit gjatë së cilës do të shqyrtohet kërkesa e autoriteteve të Serbisë për ekstradim.

Në lidhje me këtë ka reaguar Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj), duke theksuar se Emin Bajrami u arrestua për shkak se ishte në listën e Interpolit me kërkesë të Serbisë. "Fletarresti i Interpolit ndaj ish ushtarit të UÇK-së Emin Bajrami u aktivizua në muajin prill të vitit 2024. Emin Bajrami është arrestuar nën dyshim se në muajin qershor të vitit 1999 në fshatin Greme ka kërcënuar me dhunë fizike çiftin N. K dhe Z. K, burrë dhe grua të nacionalitetit serb sikur që i ka urdhëruar ta lëshojnë shtëpinë dhe pronën. Nga autoritetet e Serbisë, Emin Bajrami qenka



identifikuar në bazë të letërnjoftimit të vjetër nr. 2619333. I arrestuari Emin Bajrami ka deklaruar se në kohën kur dyshohet se është kryer vepra, ai pra nga korriku 1998 deri në shtator 1999 ka qëndruar në Gjermani, si azilkërkues duke e dëshmuar

edhe me një dokument të autoriteteve gjermane, në gjuhën gjermane e që nuk është pranuar nga autoritetet maqedonase. Gjykatësja e procedurës paraprake, Sandra Krstiq në arsyetimin e caktimit të masës së paraburgimit e thekson kërkesën e Gjykatës së

Lartë për Krime Luftë në Beograd si dhe thirret në nenet 5, 6 dhe 17 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. KMDLNj aspak nuk habitet nga autoritetet maqedonase që janë shndërruar në instrument represiv ndaj shqiptarëve që

kanë qenë pjesëtarë të UÇK-së e që e bëjnë me kërkesa të sajura të Beogradit por shfaq shqetësim që Interpol lëshon fletarreste për ish-ushtarët e UÇK-së pa u mbështetur në prova dhe pa verifikuar alibinë e të arrestuarve. Kjo sidomos po përsëritet në Maqedoninë e Veriut dhe pas shqyrtimit të provave, të arrestuarit lirohen të pafajshëm", thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

KMDLNj rithekson faktin se arrestimi i shqiptarëve me pretekst se kanë qenë ushtarë të UÇK-së nga ana e Serbisë dhe satelitëve të saj bëhet si hakmarrje për arrestimin e serbëve në Kosovë. "KMDLNj e gjykon këtë arrestim si të pambështetur në prova duke kërkuar që Emin Bajrami të lirohet sa më parë. Institucionet e Kosovës duhet të kërkojnë sqarim nga Interpol për këtë arrestim ndonëse Emin Bajrami në atë kohë ishte në Gjermani. Nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut duhet të kërkohe sqarim për këtë gjueti ndaj shtetasve të Kosovës. KMDLNj shpreson dhe pret që Emin Bajrami të lirohet nga paraburgimi dhe t'i kthehet familjes, duke mos ia mohuar lirinë e lëvizjes në të ardhmen", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

Parlamenti Evropian kërkon heqjen e masave ndëshkuese ndaj Kosovës

PRISHTINË, 19 SHKURT - Raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian, Riho Terras, përgatiti draft-raportin vjetor për situatën në Kosovë dhe përparimin e saj drejt BE-së, i cili do të paraqitet më 20 shkurt në një seancë të Komisionit të Politikës së Jashtme të PE-së.

Ky draft-raport vlerëson përkushtimin e Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian, ndërsa thekson se e ardhmja e Kosovës është në BE dhe se përpjekjet për ta nxjerrë vendin nga një zonë gri janë në interes edhe të Kosovës, edhe të BE-së.

Në këtë draft-raport mbështetet, gjithashtu, aplikimi i Kosovës për anëtarësim në BE dhe ftohen vendet anëtare, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, që ta bëjnë një gjë të tillë pa vonesa të tjera.

Dokumenti, të cilin Terras e shkroi pas konsultimeve me partnerët dhe duke marrë parasysh gjetjet e Komisionit Evropian, nënvizon "progresin domethënës në fushën e drejtësisë, të sigurisë dhe lirive, të luftës kundër krimit të organizuar dhe të funksionimit të ekonomisë së tregut", por shpreh keqardhje për përparimin e limituar në sundimin e ligjit.

Në këtë draft-raport kërkohet edhe një herë nga BE-ja t'i heqë masat ndëshkuese ndaj Kosovës të cilat i ndërmoi në qershor të vitit 2023 për shkak



të tensioneve në veriun e vendit të banuar me shumicë serbe. Ato përfshijnë ngrirjen e disa fondeve të BE-së dhe pezullimin e takimeve të nivelit të lartë me zyrtarët kosovarë. "Bëjmë thirrje për heqjen e menjëhershme të masave të BE-së ndaj Kosovës të cilat nuk janë më të arsyeshme dhe janë në kontradiktë me përkushtimin e dëshmuar të Kosovës ndaj vlerave evropiane dhe me përshtatjen e saj me politikën e BE-së", thuhet në dokument.

Parlamenti Evropian mbështet edhe kërkesën e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe planin për t'iu bashkuar programit të Partneritetit për Paqe të NATO-s.

Në raport shprehet shqetësim për gjendjen jo të kënaqshme në Kosovë sa i përket korrupsionit dhe kërkohet që, pos reformave ligjore, të ketë edhe rezultate të dukshme në hetime dhe dënime të rasteve. Shqetësim serioz shprehet edhe për dobësitë sistematike

të sistemit të drejtësisë në Kosovë, sidomos sa i përket pavarësisë dhe respektimit të ndarjeve të pushteteve. "Përsërisim shqetësimin për vonesat në rastet gjyqësore dhe kritikën nga ana e zyrtarëve të qeverisë ndaj vendimeve në rastet individuale", thuhet në draft-raport.

Shqetësim shprehet, gjithashtu, për situatën e sigurisë në veri të Kosovës, posaçërisht pas sulmit të armatosur në Banjskë në shtator të vitit 2023, dhe sulmit

në kanalën e Ibër-Lepencit në nëntor të vitit 2024.

Raporti kërkon që kryesit e këtyre veprave të dhunshme të nxirren para drejtësisë.

Aty shprehet keqardhje përse Serbia nuk i ka nxjerrë para drejtësisë "kryesit e sulmit terrorist në Banjskë, përfshirë ish-nënkryetarin e Listës Serbe, Millan Radoičiq".

Sa i përket gjendjes së medieve, raporti përmend ekzistimin e një mjedisi pluralist dhe nënvizon rolin e Komisionit të Pavarur të Medieve, autonomia e të cilit "duhet të ruhet fuqishëm".

Në raport kërkohet më shumë transparencë sa i përket pronësisë dhe financimit të medieve, ndërsa shprehet shqetësim serioz për rastet e sulmeve ndaj gazetarëve.

Dokumenti shpreh, gjithashtu, mbështetje për procesin e dialogut për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe përsëritet emërimin e Peter Sorensenit në pozitën e të dërguarit të posaçëm të BE-së për këtë dialog.

Pas paraqitjes së këtij drafti në Komisionin e Politikës së Jashtme të Parlamentit Evropian, deputetët do të kenë mundësi të paraqesin edhe amendamente në të.

Pastaj për to do të votohet së pari në Komisionin Parlamentar, më pas raporti do të miratohet si rezolutë e Parlamentit Evropian. (Radio Evropa e Lirë)

Policia në Mitrovicë mban takim me forumet e sigurisë

MITROVICË, 19 SHKURT - Në Drejtorinë Rajonale në Mitrovicë - Jug është mbajtur takim i përbashkët i përfaqësuesve të të gjitha Komiteteve Lokale të Sigurisë Publike (KLSP) të Rajonit të Mitrovicës jug dhe Mitrovicë veri.

Të pranishmit u pritën nga eprorë të DRP-Mitrovicë jug, ndërsa temë kryesore e takimit ishte fuqizimi dhe rivitalizimi i këtyre forumeve të cilat janë tejet të rëndësishme për sigurinë në bashkësi duke punuar në partneritet me

Policinë e Kosovës.

Përfaqësuesit e KLSP-ve njoftuan për sukseset dhe sfidat gjatë vitit 2024, gjithashtu edhe për objektivat të cilat synojnë t'i realizojnë gjatë vitit 2025 në aspektin e sigurisë në bashkësi.

Pjesëmarrësit në takim ndanë idetë e tyre për funksionimin sa më të mirë të KLSP-ve, bashkëpunimin mes tyre si dhe identifikimin e problemeve të sigurisë të bashkësive ku ata veprojnë dhe funksionojnë.

Kërkesë e KLSP-ve ishte

rivitalizimi i këtyre forumeve të sigurisë me anëtarë të rinj dhe sigurimi i trajnimeve për këta anëtarë të rinj që në të ardhmen ata të kontribuojnë sa më mirë në këto forume të sigurisë.

Nga ana e policisë u vlerësua pozitivisht puna e KLSP-ve në aspektin e parandalimit të dukurive negative, njëherësh u rikonfirmua mbështetja dhe përkrahja e vazhdueshme e policisë ndaj këtyre forumeve në interes të sigurisë së përbashkët.



A ËSHTË PAVARËSIA E KOSOVËS NË BANKËN E ZEZË NË HAGË?



Milazim KRASNIQI

A i di ndokush shkakun e vërtetë pse Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli e Rexhep Selimi janë në bankën e të akuzuarve në Gjykatën Speciale? Ka pasur e ka shumë supozime, hipoteza, qëndrime, konstatime lidhur me këtë temë, por as nuk ka qartësi e as konsensus për shkakun kryesor, pse pikërisht ata janë të akuzuar. Ka mundur të ishin të akuzuar mbase shumë të tjerë për krimet e supozuara, ose edhe të kryera nga pjesëtarë të UÇK-së. Ajo ka qenë luftë e armatosur dhe në luftë vriten e plagosen njerëz.

Në një gjykatë që kërkon të vendos drejtësi, vihen në bankën e të akuzuarve ata që i kanë kryer krimet. Edhe në rastin e ushtrive të rregullta, me përparësi akuzohen kryesit e krimeve. Ndërsa në rastin e ushtrive që janë më shumë guerile, ajo është e vetmja mënyrë për të vënë drejtësi, pasi në ushtri të tilla nuk ka një strukturë hierarkike. Pra, mbetet pyetja: pse në rastin e UÇK-së, janë akuzuar drejtuesit politikë, e jo fjala vjen, kryesit lokalë të krimeve eventuale?

Bindja ime e thellë është se ka një shkak të vetëm: Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi e Kadri Veseli, me gjasë edhe Rexhep

Selimi bashkë me ta, kanë qenë personat kyç që e kanë prishë projektin për riintegrimin e Kosovës në Jugosllavi, ashtu siç ka qenë akordi në marrëveshjen e Ahtisarit e Çernomyrdinit me Millosheviqin dhe siç është inkorporuar edhe në rezolutën 1244 të KS të OKB-së. Kjo ka qenë linja absolute ndërmjet SHBA-së, BE-së dhe Rusisë. Kjo është tentuar të imponohet edhe në terren me UNMIK-un dhe KFOR-in në vitet e para. Disa nga njerëzit që kanë paraqitë pengesë ndaj këtij projekti, ose janë eliminuar politikisht, ose janë ndjekur nga drejtësia e UNMIK-ut, ose kanë vdekur. Ata që kanë mbijetuar politikisht, që nuk i ka arrit

drejtësia e UNMIK-ut dhe nuk kanë vdekur, janë pikërisht Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi. Dy të parët (Hashim Thaçi si kryeministër dhe Jakup Krasniqi si kryetar i Kuvedit) kanë pasur rol vendimtar në shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008.

Këtu shtrohet një pyetje shumë e vështirë: pse edhe amerikanët e kanë shtyrë përpara dhe e kanë imponuar me presion themelimin e Gjykatës Speciale? Ka vetëm një shpjegim të logjikshëm: për të dalë të larë para rusëve, me arsyetimin se protagonistët e shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 kanë përgjegjësinë e tyre individuale. Pra, amerikanët nuk e kanë prishur marrëveshjen me rusët, po atë marrëveshje e kanë injoruar protagonistë vendas. Si rrjedhojë ata do të akuzohen në Gjykatën Speciale dhe do të nxirren nga skena politike, për të marrë rusët një satisfaksion. Të tjerat mandej janë teknikalitete. Pra, shkakun kryesor i akuzës ndaj tyre është shpallja prej tyre e pavarësisë së Kosovës në kundërshtim me akordin Ahtisari-Çernomyrdin-Millosheviq dhe me rezolutën 1244. Mbetet po ashtu propozimi për pavarësinë e kushtëzuar në Planin Gjithpërfshirës të Ahtisarit, kur dihej se Ahtisari në vitin 1999 ishte haptas dhe qartësisht

kundër pavarësisë së Kosovës. E logjikshme duket se edhe atij iu imponuar ndryshimi i qëndrimit në favor të pavarësisë nga këmbëngulësia e politikës independentiste në terren, të akterëve të tipit të Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, po edhe Ibrahim Rugova e Fatmir Sejdiu. Në pamundësi që të pengohet pavarësia e Kosovës me çdo kusht, u imponua si pavarësi e kushtëzuar, por më vonë u penalizuan protagonistë kryesorë që e shpallën pavarësinë, përfshirë edhe ish president Fatmir Sejdiun.

Ajo që unë nuk mund as ta prognozohet me këtë rast është se si do të ndikojë verdikti i Gjykatës Speciale mbi shtetin tonë, më saktë mbi ekzistencën e tij. Këtë nuk mund as ta supozoj. Shpresa është se me Trampin në Shtëpinë e Bardhë nuk ka shans të rikthimit të akordi i vitit 1999. Por, me Trampin poashtu është e sigurt se statu quoja nuk mund të mbahet gjatë. Nuk mund ta dimë sot se a do të tentohet të zgjidhet problemi si krizë ndërmjet Kosovës e Serbisë, apo në një konstelacion më të gjerë të sigurisë evropiane, përfshirë edhe rastin e Ukrainës. Për të përballuar gjithë sfidat e mundshme, na duhet një qeveri që e fiton besimin e SHBA-së dhe e dyta, na duhet Hashim Thaçi me shokët e tij në liri.

Akademiku Arsim Bajrami: Serbia ka kryer gjenocid në Kosovë

Prishtinë, 19 shkurt - Të mërkurën në Prishtinë, organizuar nga Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (IKKL), është mbajtur konferenca ndërkombëtare për krimet e luftës të kryera nga Serbia në Kosovë.

Akademiku Arsim Bajrami në këtë konferencë, në cilësinë e panelistit të parë, ka paraqitur kumtesën me titull "Kualifikimi juridik i krimeve të luftës dhe

gjenocidit të Serbisë në Kosovë". Konkluzë e kësaj kumtese ishte se Serbia gjatë viteve 1998-1999 ka kryer gjenocid ndaj shqiptarëve të Kosovës, ku u theksua se ky gjenocid është orkestruar, organizuar dhe implementuar nga shteti serb përmes një "plani special-dolus specialis", i cili ka pasur për qëllim shkatërrimin biologjik të kombit shqiptar, me qëllim të ndërrimit të strukturës

etnike dhe zbatimit të "mitit të rrejshëm serb" për Kosovën si tokë e "shenjtë serbe". "Gjenocidi i Serbisë në Kosovë, si një ndërmarrje e përbashkët kriminale e shtetit serb, është krim i gjenocidit dhe përmbush kriteret e Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 1948", ka thënë Bajrami.



PROKURORIA I KËRKON GJYKATËS TA URDHËROJË KURTIN TË PARAQITET DËSHMITAR NË RASTIN E REZERVAVE



PRISHTINË, 19 SHKURT - Prokuroria Speciale i ka bërë kërkesë Gjykatës Themelore në Prishtinë ta urdhërojë kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, të paraqitet në Prokurori në cilësinë e dëshmitarit në një rast të hapur lidhur me dyshimet për keqpërdorime me rezervat shtetërore, pasi Kurti kishte refuzuar dy ftesat e mëparshme.

Mirlinda Gashi, zëdhënëse e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka konfirmuar për Radion Evropa e Lirë se kërkesa është pranuar dhe se ajo "është duke u shqyrtuar nga gjykata". Në Kodin e Procedurës Penale thuhet se një gjyqtar, sipas detyrës zyrtare, apo me kërkesë të Prokurorit të Shtetit, mund ta detyrojë një dëshmitar që të paraqitet.

Gzim Shala nga Instituti i Kosovës për Drejtësi ka thënë për REL-in se edhe pse nuk ka ndonjë afat kohor se kur duhet të vendosë gjykata lidhur me kërkesën e prokurorisë, një gjë e tillë "duhet të bëhet pa vonesë".

E nëse pas urdhrat gjyqësor i ftuari nuk paraqitet në Prokurori, gjyqtari e dënon atë me gjobë prej 250 eurosh sa herë që ai refuzon. Por, nëse ka refuzim edhe pas shqiptimit të gjobave, ai mund të burgoset, por jo më shumë se një muaj. "Burgimi zgjat derisa dëshmitari nuk pranon të dëshmojë apo derisa dëshmimi i tij bëhet i panevojshëm, ose derisa procedura të përfundojë, por jo më shumë se një muaj", thuhet në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. Qeveria e Kosovës nuk është përgjigjur në kërkesën e REL-it për koment ndaj kësaj kërkesë të Prokurorisë Speciale.

Në dhjetor të vitit të kaluar Prokuroria Speciale e kishte ftuar Kurtin të paraqitet në cilësinë e dëshmitarit në një rast të hapur lidhur me dyshimet për keqpërdorime me rezervat shtetërore. Kurti kishte refuzuar të paraqitej në Prokurori, duke u bërë thirrje prokurorëve të shkojnë ta intervistojnë në zyrën e tij në Kryeministri.

Ftesën e parë Kurti e kishte marrë më 16 dhjetor, kur zëdhënësi i qeverisë, Përparim Kryeziu, kishte thënë se Kurti nuk ishte paraqitur pasi që ishte në udhëtim jashtë vendit dhe kishte shtuar se Kurti "ka shprehur gatishmërinë t'i mirëpresë prokurorët e rastit në zyrën e tij në një ditë dhe orë të dakorduar nga të dyja palët për ta përmbushur kërkesën e dalë nga ftesa e Prokurorisë". Katër ditë më vonë Kurti kishte marrë sërish ftesë nga Prokuroria, së cilës prapë nuk i ishte përgjigjur pozitivisht.

Ftesa e Kurtit që prokurorët ta intervistojnë atë në zyrën e tij është kritikuar nga ekspertë ligjorë, si Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe Viona Bunjaku nga Lëvizja FOL.

Miftaraj kishte thënë se "nëse prokurorët nuk kanë guxim profesional", atëherë jo vetëm kryeministri, por edhe qytetarët e zakonshëm "mund të tallen dhe të mos e respektojnë autoritetin e Prokurorisë".

Rasti i rezervave shtetërore

Më 2023 tre persona ishin arrestuar për rastin e rezervave shtetërore. Në mesin e tyre ishin edhe punonjës të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), që udhëhiqet nga Rozeta Hajdari, e cila, gjatë paraqitjes për dëshmi në Prokurorinë Speciale, ka zgjedhur të mbrohet në heshtje.

Në këtë ministri më 2023 u kryen bastisje pas publikimit të audioincizimeve nga portali Nacionale, ku pretendohet se një sasi vaji, e blerë në Poloni, dhe një sasi gruri, e blerë në Turqi, nuk kishin arritur kurrë. Qeveria ka thënë se pagesat për rezervat shtetërore ishin bërë në përputhje me ligjin. Hajdari tha në atë kohë se blerjet për rezerva shtetërore janë bërë në përputhje me ligjin, por nuk dha më shumë hollësi, meqë informacionet

për to janë sekrete shtetërore. Ajo e akuzoi policinë se gjatë bastisjeve ka marrë në cilësinë e provave dokumente të klasifikuara si sekrete shtetërore.

Kurti i doli në mbrojtje Hajdarit, duke thënë se "nuk ka kurrfarë korrupsioni e keqpërdorimi". "Unë kam besim të plotë në ministrin Rozeta Hajdari dhe në punën e saj", tha ai dhe akuzoi, siç u shpreh, "elitën e vjetër dhe të korruptuar politike, gjykatësit e prokurorët e saj dhe mediet e keqpërdorura për mbështetje të krimin".

Në përgjigje, Këshilli Prokurorial i Kosovës i kërkoi Kurtit që "të përmbahet nga deklaratat shantazhuese dhe nënçmuese".

Tetë muaj më vonë, në prill të këtij viti, vetë Hajdari u ftua për intervistim nga Prokuroria Speciale, nën dyshimet se ka keqpërdorur detyrën zyrtare në lidhje me rezervat shtetërore. Në paraqitjen e saj para prokurorëve, ajo e mbrojti veten në heshtje.

Krasniqi takon Prattipatin: Kosova ka nevojë sa më shpejt për një qeveri të re

Prishtinë, 19 shkurt - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka takuar të ngarkuarën me punë në Ambasadën e Amerikës, Anu Prattipati. Një diskutim i hapur dhe pozitiv mbi zgjedhjet e 9 shkurtit, respektimin e vullnetit qytetar dhe përmblylljen e procesit në mënyrë demokratike - ashtu siç e meriton Kosova. PDK beson se vendi ka nevojë sa më shpejt për një qeveri të re, stabile dhe të përgjegjshme.

Në platformën sociale "Facebook", Krasniqi, pas takimit, ka shprehur besimin se Kosova "ka nevojë sa më shpejt për një qeveri të re, stabile dhe të përgjegjshme". "Në vazhden e takimeve me misionet

diplomatike në Kosovë, sot pata kënaqësinë të pres në selinë e PDK-së të Ngarkuarën me Punë në Ambasadën Amerikane, Anu Prattipati. Një diskutim i hapur dhe pozitiv mbi zgjedhjet e 9 shkurtit, respektimin e vullnetit qytetar dhe përmblylljen e procesit në mënyrë demokratike - ashtu siç e meriton Kosova. PDK beson se vendi ka nevojë sa më shpejt për një qeveri të re, stabile dhe të

përgjegjshme. Pavarësisht rrethanave politike, angazhimi ynë për të mirën e qytetarëve dhe forcimin e institucioneve të shtetit mbetet i palëkundur. ShBA-ja ka qenë dhe mbetet partneri ynë strategjik. E falënderova zonjën Prattipati për mbështetjen e jashtëzakonshme që ShBA-ja i ka dhënë Kosovës në çdo hap të rrugëtimit të saj", ka shkruar Krasniqi.



Kosova dhe Shqipëria fillojnë auditimin paralel "Mbrojtja dhe siguria e digave"

PRISHTINË, 19 SHKURT - Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës (ZKA) dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë (KLSH) mbajtën të mërkurën takim pune në kuadër të auditimit paralel të performancës për mbrojtjen dhe sigurinë e digave në të dyja vendet.

Takimi i mbajtur në ambientet e ZKA-së në Prishtinë synon thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve të auditimit dhe shkëmbimin e përvojave për ta përmirësuar kontrollin dhe sigurinë e infrastrukturës së digave.

Takimi u hap me fjalët

përhëndetëse të auditores së përgjithshme Vlora Spanca, dhe të kryetarit të KLSH-së, Arben Shehu, të cilët theksuan rëndësinë e këtij bashkëpunimi për rritjen e transparencës dhe efikasitetit në auditimet publike. "Është kënaqësi e veçantë ta realizojmë auditimin e tretë paralel me Kontrollin e Lartë të Shtetit, përmes të cilit kemi edhe një mundësi të shkëlqyer për t'i forcuar më tej marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve tona", ka theksuar auditorja Vlora Spanca.

Ndërkaq kryetari i KLSH-së, Arben Shehu, ka thënë se është jashtëzakonisht e rëndësishme ta ofrojnë kontributin e tyre në ZKA dhe KLSH, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë.

Më tutje, përgjatë takimit, ekipet audituese të ZKA-së dhe të KLSH-së paraqitën analizat e tyre për gjendjen e digave në Kosovë dhe Shqipëri, sfidat dhe mundësitë për përmirësim. Diskutimet u fokusuan në planifikimin e auditimit paralel, i cili do të ndihmojë në identifikimin e dobësive dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit



mbi sigurinë e digave.

Ky aktivitet shënon vazhdimin e bashkëpunimit në mes të ZKA-së dhe KLSH-së për ta

forcuar llogaridhënien dhe transparencën në menaxhimin e resurseve publike.

Qeveria maqedonase kufizon marzhën e fitimit për 102 grupe produktesh

SHKUP, 19 SHKURT - Qeveria e Maqedonisë së Veriut ka miratuar vendimin për kufizimin e marzhës së fitimit për 102 grupe produktesh që përfshijnë mbi 1 000 artikuj ushqimorë dhe joushqimorë, me synimin për t'i ulur çmimet dhe për t'i "mbrojtur qytetarët" nga rritjet e çmimeve. Sipas vendimit, për tetë produkte bazë, përfshirë bukën, miellin, vajin, vezët, marzha nuk duhet të kalojë mbi 5 %. Për 55 produkte të tjera, si mish dhe produktet e konservuara, kufiri është 10 %, ndërsa për 39 produkte të tjera si fruta, perime dhe artikuj higjienikë, marzha lejohet deri në 15 %.

Zëvendësministri i Ekonomisë dhe Punës, Marjan Risteski, deklaroi se tregtarët do të jenë të detyruar të mbajnë në raftet e tyre të paktën 70 për qind të këtyre produkteve. "Pritjet tona janë që me këto dy vendime çmimet e produkteve bazë ushqimore të ulen mesatarisht për rreth 10 për qind, me përjashtim të tetë produkteve bazë ushqimore - qumësht, bukë, miell tipi 400 dhe 500, vezë, vaj për gatim, kos dhe



dhallë, për të cilat pritet të mbeten në të njëjtin nivel, pra të mos rriten ose të kenë një ulje minimale", tha Risteski në konferencën për shtyp më 18 shkurt.

Vendimi, i cili pritet të hyjë në fuqi të mërkurën dhe të zbatohet deri më 30 prill, vjen pas dy bojkotimeve të blerjeve nga qytetarët në shenjë pakënaqësie për çmimet e larta të ushqimeve.

Ndërkohë Oda Ekonomike e

Tregtarëve me shumicë dhe pakicë ka paralajmëruar se masat mund ta rrezikojnë mbylljen e marketeve pasi, sipas saj, harxhimet bazë të tregtarëve lëvizin nga 12 deri në 15 për qind. Ata paraprakisht propozuan që kufizimi të zbatohet për 200 produkte, në vend të 1 000 produkteve të përcaktuara nga Qeveria.

Nga Lidhja Socialdemokrate (LSDM) në opozitë, më herët

gjatë ditës propozuan heqjen e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) për ushqimin. Deputetja e kësaj partie, Jovanka Trençeska, tha se vetëm në këtë mënyrë do t'u ndihmohet qytetarëve, të cilët, siç tha, mezi ia dalin dhe po përballen me kushte gjithnjë e më të vështira për jetesë. "Energjia elektrike do të bëhet 13 % më e lirë, qytetarët do të mund të kursejnë rreth 400 denarë në një faturë prej 3 000

denarësh... Mbi 250 kategori produktesh ushqimore do të bëhen 5 % më të lira. Kjo sjell një kursim të drejtpërdrejtë prej 2 000 denarësh në muaj ose 24 000 denarësh në vit", tha Trençeska.

Megjithatë, qeveria maqedonase tani beson se këto masa do t'i "mbrojnë qytetarët" nga rritjet e çmimeve dhe të krijojnë një ekuilibër më të drejtë në treg. Autoritetet kanë paralajmëruar edhe gjoba deri në 20 000 euro për ata që nuk respektojnë kufizimet.

Ky vendim u bazua në raportin gjashtëmuor të Inspektoratit Shtetëror të Tregut, sipas të cilit, u konstatua se tregtarët me pakicë kishin më shumë se 20 për qind marzhë për produktet bazë ushqimore dhe mbi 30 për qind marzhë për produktet e higjienës personale, ndërsa te importuesit dhe distributorët u regjistruan marzha më të larta deri në 50 për qind. Sipas raportit, importuesit dhe distributorët shënonin fitime edhe më të larta, me marzha deri në 50 %.

"Independent": Shqipëria ndër destinacionet më të bukura për t'u vizituar më 2025

Tiranë, 19 shkurt - Shmangni destinacionet e mbipopulluara dhe zbuloni disa nga vendet e qeta, por sensacionale të pushimeve për një arratisje të paharrueshme këtë vit, shkruan Daniel Stables në të përditshmen britanike "Independent".

Sot turizmi masiv është bërë një problem në cepat e botës ku njerëzit nuk kishin shkelur një ose dy shekuj më parë, aq më pak në Francë. Antarktida po mbushet me anije lundrimi dhe shpesh shfaqen bllokime të trafikut në majën e

Everestit. Kjo nuk është vetëm e tmerrshme për mjedisin, por është një mënyrë e sigurt për t'i prishur pushimet. Ne ju sugjerojmë disa destinacione më pak të vizituara në të gjithë botën, të cilat janë po aq magjepsëse sa vendet homologe më të njohura si: Shqipëria; Oman; Sulawesi, Indonezi dhe Zimbabve.

Shqipëria: Male të larta, plazhe të mahnitshme dhe ishuj që shkëlqejnë në detin Jon - Greqia është e bukur në pranverë, por fqinja e saj ballkanike, Shqipëria, i premtan të gjitha këto

thesare, me shumë më pak vizitorë dhe një larmi më të madhe peizazhesh natyrore në një sipërfaqe toke më të vogël. Parku Kombëtar i Thethit, në veri të vendit, është shtëpia e ecjeve të shkëlqyera dhe pamjeve befasuese si Syri i Kaltër, një burim karstik me ujëra të kaltra. Aty pranë, Bjeshkët e Nemuna, formojnë Alpet Dinarike. Ky vend me majat e frikshme, të thepisura, që rrethojnë luginat e gjelbra akullnajore - me lule të egra në pranverë, sigurisht që ia vlen të vizitohet përpara se të



zbulohet dhe të bëhet një nga destinacionet më të nxehta të ecjes në Evropë. Kryeqyteti i

gjallë, Tirana, ju jep ndjesinë e një vendi që kompenson kohën e humbur.

Bisedime “prapa shpine”



Elefanti në dhomë është shteti që ende nuk është i pranishëm.

Pavarësisht sigurisë së dhënë nga Sekretari amerikan i shtetit se Kievi do të përfshihet në bisedimet mbi të ardhmen e tij, ka shumë pak prova për këtë.

Po ashtu, Ukraina nuk do të jetë shumë e inkurajuar nga diskutimet në Riad.

Kini parasysh përmbledhjen që bëri ministri i jashtëm rus, Sergei Lavrov: “Kam arsye të besoj se pala amerikane ka filluar të kuptojë më mirë pozicionin tonë, të cilin e kemi

parashtruar sërish në detaje, duke përdorur shembuj konkretë, bazuar në fjalimet e përsëritura të Presidentit Putin.”

A do të thotë “të kuptojë më mirë”, kalimin përtej një pozicioni ku Ukraina dorëzon territor dhe heq dorë nga çdo ambicie për anëtarësim në NATO?

Ky është tashmë terreni që amerikanët e kanë vënë në diskutim – të dëgjosh që Rusia ka marrë siguri dhe garanci, nuk e ndihmon aspak idenë se Ukraina dhe aleatët europianë do të jenë të përfshirë dhe do të

ndikojnë në proces.

Rusët i kanë paraqitur këto bisedime si një përpjekje për të përmirësuar marrëdhëniet SHBA-Rusi.

Është një vizion që e ndajnë edhe amerikanët. Sekretari amerikan i shtetit e mbështeti këtë vizion dhe foli për rikthimin e stafit në ambasadat përkatëse, si dhe eksplorimin e një bashkëpunimi më të ngushtë ekonomik.

Madje, ai përmendi interesat ruse për t’i bërë vendet europiane të heqin sanksionet, duke deklaruar: “Bashkimi European do të

duhet të jetë në tryezë në një moment, pasi edhe ata kanë vendosur sanksione.”

Sa i përket Ukrainës, Marco Rubio foli për krijimin e një “ekipi të nivelit të lartë” për të mbështetur bisedimet e paqes për Ukrainën, por çdo detaj tregon se interesi për Ukrainën mbetet një prioritet i ulët.

Sekretari amerikan i shtetit tha se do të duheshin lëshime nga të gjitha palët – por kjo nuk përputhet me pikënisjen e Ukrainës për negociata, që është se lëshimet duhet të vijnë nga agresori.

Ata që janë pranë Donald Trump-it flasin për ambiciet e tij më të gjera për një ribërje të strukturës gjeopolitike, ku marrëdhëniet më të ngushta me Moskën janë në qendër. Të njëjtët njerëz thonë se Ukraina është vetëm një pjesë e vogël e kësaj tabloje. Asgjë nga çfarë ndodhi në Riad nuk e kundërshton këtë mesazh.

Ndërkohë, Volodymyr Zelenskyy ishte i qartë: Bisedimet për të negociuar paqen në luftën me Rusinë nuk duhet të zhvillohen pas shpinës së Ukrainës. / bota.al

EURO GLASS
SAINT-DOSAIN SEKURIT PILKINGTON ENVERI
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova U17 pëson humbje nga Italia

PRISHTINË, 19 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës U17 në hendboll e ka zhvilluar të mërkurën paradite ndeshjen e radhës në Kampionatin Mesdhetar

në Podgoricë. Hendbollistet "dardane" të reja janë angazhuar, por sërish paraqitja nuk ishte e mjaftueshme për fitore. Italia fitoi me rezultat 20:15.

Kosova e fitoi periudhën e tretë dhe i takojnë pikët për këtë. Sërish kishte lëshime në lojën e Përfaqësueses së Kosovës, ndërsa vajzat po e kuptojnë se për sukses në

nivel serioz ndërkombëtar u duhet shumë më tepër punë e përkushtim në stërvitje. Ka pasur edhe elemente të mira në lojën e Kosovës U17, por vetëm në momente.



'Ylli i javës' në Superligë, Jaroviç: Do të vazhdojmë me fitore

PRISHTINË, 19 SHKURT - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë të japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 20-të në Albi Mall Superligë i është dhënë sulmuesit të SC Gjilanit, Senad Jaroviç. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, në përbërje të Shyqeri Salihut, Enver Prapashticës dhe Vllaznim Visokës. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e njëzet t'i takojë Senad Jaroviçit, i cili arriti që me golat e tij ta dërgojë skuadrën e tij në avantazh dy

herë dhe t'i arkëtojë tri pikë shumë të rëndësishme për skuadrën e tij, SC Gjilani, në ndeshjen kundër kampionit aktual, FC Ballkani, të cilin e fitoi me rezultat 2:1. Pasi mori këtë çmim, Jaroviçi u shpreh i lumtur që u vlerësua më i miri i javës: "Jam shumë i lumtur për shpërblimin personal, por në radhë të parë për ekipin, sepse kemi pasur një javë të vështirë. E nisëm mirë. Patëm pak fat dhe menduam se do të shkonte gjithçka mirë. Humbëm kupën dhe pastaj ishte edhe më e rëndësishme të fitonim kundër Ballkanit. Tani kemi dy fitore në kampionat dhe shpresoj që të



vazhdojmë kështu. Dua ta falënderoj ekipin sepse bëmë një punë shumë të mirë. Qëndruam të bashkuar gjithë ekipi. Gjithashtu falënderime

për trajnerët të cilët na mbajtën pozitivë, sepse në këto situata nuk është gjithmonë e lehtë të rikthehesh më i fortë. Sidomos

kundër Ballkanit, kampionit aktual. Mendoj se tani jemi në rrugën e duhur dhe duam të vazhdojmë me rezultate pozitive në kampionat. Tani kemi atmosferë shumë të mirë në ekip dhe do të arrijmë rezultate të mira. Unë besoj në ekip. Siç e dini, ne kemi një ekip të mirë. Kemi shumë lojtarë të rinj që janë bashkuar gjatë verës. Pra, fakti që kemi një ekip të mirë është i qartë, por tani kemi edhe kiminë gjithnjë e më të mirë mes nesh. Patëm një fazë të mirë përgatitore dhe, ashtu siç e nisëm, do të vazhdojmë me fitore, shpresoj", ka thënë Jaroviçi për faqen zyrtare të FFK-së.

Kosova kërkon fitore ndaj Azerbajxhanit

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 19 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll do të zhvillojë dy ndeshje shumë të rëndësishme për parakualifikimet për FIBA Kupën e Botës 2027. "Dardanët" ndeshjen e parë do të zhvillojnë sonte (e enjte) nga ora 19:30 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë ndaj Azerbajxhanit. Para këtyre dy ndeshjeve vendimtare për Kosovën ka folur basketbollisti i Kosovës, Gëzim Morina, i cili ka paralajmëruar se "dardanët" do ta japin maksimumin për të shënuar fitore ndaj Azerbajxhanit. "Që nga e diela



jemi grumbulluar këtu në Prishtinë. Rëndësi të madhe ka se nuk jemi përballur me lëndime dhe kësaj radhe jemi të kompletuar. Na pret një ndeshje e vështirë ndaj Azerbajxhanit, por ne do ta

japim maksimumin që të fitojmë dhe t'i mbajmë gjallë shpresat për kualifikim. I ftojme të gjithë që të vijnë dhe të na përkrahni, pasi me ndihmën tuaj gjithçka është e mundur", ka thënë Morina.

Ndeshjen e dytë në këtë muaj Kosova e zhvillon më 23 shkurt ku do të përballet me Kombëtaren e Zvicrës. Edhe ndeshja e dytë zhvillohet nga ora 19:30. Para dy ndeshjeve mjaft të rëndësishme ka folur edhe kapiteni i Kosovës, Dardan Berisha. Ai i ka ftuar tifozët "dardanët" që të jenë në numër të madh në sallë për ta përgatitur Kosovën drejt rezultateve pozitive. "Përgatitjet kanë shkuar mirë. Jemi përgatitur nga dy herë në ditë. I kemi dy ndeshje me rëndësi dhe të vështira dhe besoj se 'dardanët' do ta mbushin sallën dhe të na mbështesin pasi kemi nevojë të madhe. Motivin e kemi maksimal dhe dihet për çka po luajmë dhe kënd e

prezantojmë. Ftoj tifozët që ta mbushin sallën dhe bashkë t'i festojmë rezultatet pozitive", ka thënë Berisha. Duke parë rëndësinë e ndeshjes, edhe Federata e Basketbollit ka bërë thirrje për përkrahje sa më të madhe: "Kjo është një sfidë shumë e rëndësishme, pasi dardanët kanë nevojë për përkrahje nga tifozët në rrugën e kualifikimit". Kosova deri tash ka zhvilluar katër ndeshje, ku ka regjistruar një fitore dhe tri humbje. "Dardanët" renditen në vendin e katërt me pesë pikë, aq sa ka edhe Azerbajxhani në vend të tretë. Në vendin e dytë është Irlanda me gjashtë pikë, kurse Zvicra e kryeson grupin me tetë pikë të grumbulluara.

Caktohen çiftet çerekfinale të Kupës në futboll

PRISHTINË, 19 SHKURT - Në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës të mërkurën në prani të Komisionit të Garave dhe përfaqësuesve të klubeve është hedhur shorti për fazën çerekfinale të Kupës së Kosovës në futboll, duke përcaktuar përballjet e

kësaj faze të rëndësishme të garës. Ndeshja më interesante padyshim që pritet të zhvillohet në Gjakovë, ku rivalët e vjetër, Vëllaznimi dhe Prishtina, luftojnë për një vend në gjysmëfinale. Përballje e fortë pritet të zhvillohet edhe mes dy ekipeve të

Superligës së Kosovës, Malisheva dhe Llapi. Në dy ndeshjet e tjera do të luajnë Drenica - Ferizaj dhe Prishtina e Re - Drita, ku ekipet e Superligës për një nuancë janë më favorite. Ndeshjet do të zhvillohen më 26 shkurt dhe premtojnë sfida

interesante mes ekipeve që synojnë të avancojnë në gjysmëfinale.

ÇIFTET ÇEREKFINALE:

Drenica - Ferizaj
FC Malisheva - Llapi
Prishtina e Re - Drita
Vëllaznimi - Prishtina



Gjimshiti pas eliminimit: Të mësojmë nga gabimet

BERGAMO, 19 SHKURT - Berat Gjimshiti ka parë se si ëndrrat e Atalantës për një edicion si protagoniste në Ligën e Kampioneve të shuhën me një humbje 3-1 në shtëpi përballë Club Brugge. Një humbje e papritur që ka lënë një zhgënjim të madh, siç e

pranoi pas ndeshjes mbrojtësi shqiptar. “Është e vështirë të gësh fjalët. Komplimente atyre. Në pjesën e parë kanë bërë tre gola në kundërsulm. Duke shënuar menjëherë, komplikuan ndeshjen tonë. Gjëja më e rëndësishme ishte

shpirti. Nuk u dorëzuam. Tani duhet të rinisemi dhe mendojmë për kampionatin. Ata kanë një skuadër të mirë. Luajnë mirë futboll. Na vendosën më shumë në vështirësi në ndeshjen e parë sesa në të dytën, ku ishin vdekjeprurës. Në një ndeshje

kaq të rëndësishme nuk mund të shkosh në dizavantazh 0-3 në fund të pjesës së parë. Tani duhet t'i karikojmë bateritë, të mësojmë nga gabimet dhe të rinisemi”, ka thënë mbrojtësi shqiptar për “Sky Sport” pas ndeshjes.



Në 75-vjetorin e Formulës 1 paraqiten të gjitha makinat dhe pilotët

LONDËR, 19 SHKURT - Në një mbrëmje magjike të organizuar në “O2 Arena” të Londrës u zhvillua ceremonia madhështore e prezantimit të 10 makinave të sezonit 2025 të Formulës 1. Ky vit përkon me 75-vjetorin e garave, ndaj dhe u zhvillua një ceremoni që zgjati mbi tri orë dhe ku të pranishëm ishin të 20 pilotët e këtij sezoni, drejtuesit e skuadrave dhe mjaft personazhe VIP të ftuar. Mbrëmja “gala”, e mbushur me shumë emocione dhe batuta, u drejtua nga aktori Jack Whitehall, i shoqëruar me muzikë “live” nga Kane Brown, Brain Tyler dhe Take That. Nga Max Verstappen te Lando Norris, nga Lewis Hamiltoni te Kimi Antonelli, mjaft kampionë dhe debutues parakaluan bashkë me makinat e tyre në skenën e improvizuar, duke zbuluar njëvendëshet e këtij sezoni.



Prezantimi i makinave u bë në bazë të renditjes për konstruktorët të sezonit të kaluar dhe në fund doli McLareni. Një mbrëmje e konceptuar edhe në formën e një spektakli, ku ovacionet nuk munguan kur dilnin pilotët. Parakalimi i

Hamiltonit me uniformën Ferrari, apo dalja e Verstappenit kampion bote, sollën ovacionet më të mëdha në sallë. Një sezon që parashikohet mjaft i fortë, ndaj dhe Formula 1 vendosi të paraqitet në një mënyrë unike për fansat.

Yamali nuk e përjashton mundësinë që gjithë karrierën ta kalojë në Barcelonë

BARCELONË, 19 SHKURT - Kontrata e Lamine Yamalit me Barcelonën skadon në qershor 2026, por talenti i ri tashmë ka pranuar ofertën për ta zgjatur deri më 2030. Zyrtarizimi do të bëhet pas 13 korrikut, kur ai të mbushë 18 vjeç. “Nuk mendoj se dikush dyshon në dashurinë time për këtë klub. E kam thënë gjithmonë dhe besoj se gjithçka do të shkojë mirë. Nëse të dyja palët e duan, do të ndodhë. Nuk besoj se dikush mund të dyshojë në ndjenjat e mia për këtë klub”, ka thënë talenti katalanas në një intervistë për “Mundo Deportivo”. Lidhur me “paktin” e famshëm, ai u shpreh: “E vërteta është se nuk jam i përfshirë në të gjitha këto gjëra. Ka ende shumë rrugë për të bërë deri në përfundimin e këtij sezoni. Në fillim të sezonit të ardhshëm gjithçka do të jetë e qartë dhe të gjithë do ta kuptojnë. Tani jam i



përqendruar te La Liga, Ligën e Kampioneve dhe Kupën e Mbretit, që janë gjërat më të rëndësishme”. Për ofertën e mundshme nga PSG-ja, Yamali është përgjigjur: “Nuk di asgjë, por edhe nëse një ofertë do të vinte te njerëzit rreth meje, nuk do të ma thoshin as mua. Së pari, sepse kam një kontratë dhe, së dyti, sepse besoj se për mua është e pamundur të shkoj në një klub tjetër. Te Barcelona për gjithë jetën? Epo, është e

vetmja skuadër ku kam luajtur, përveç La Torreta ku fillova. Por po, i detyrohem gjithçka Barcelonës. Më pëlqen gjithçka këtu: skuadra, klubi, tifozët, dhoma e zhveshjes, stafi. Këtu te Barcelona gjithçka është e përkryer. E vërteta është se jam shumë i lumtur që nga dita kur nisa të stërvitem me ekipin e parë. Mikpritja dhe dashuria që më kanë treguar tifozët e shokët e skuadrës janë të jashtëzakonshme”.

SHKURT

Jashari, lojtari i ndeshjes kundër Atalantas

Skuadra belge Club Brugge është në mesin e 16 skuadrave më të mira të Ligës së Kampioneve. Mbrëmë ekipi ku luan edhe futbollisti me prejardhje nga Kosova, Ardon Jashari, fitoi përballë Atalantas, ku luan shqiptari tjetër, Berat Gjimshiti. Rezultati i përgjithshëm nga ta dyja ndeshjet ishte 2:5 për Bruggen. E mbrëmë kontribut të madh në fushë dhe reprezentuesi i Kombëtares së Zvicrës, Ardon Jashari. Ishte pikërisht Jashari ai që u shpall edhe lojtari i ndeshjes. 22-vjeçari ishte “komandant” i mesfushës së skuadrës nga Belgjika.

Broja rikthehet javën e parë të marsit

Muajin tjetër Shqipëria do ta nisë fushatën kualifikuese të Botërorit 2026, një turne ku pjesëmarrja mbetet një ëndërr për çdo tifoz kuqezi. Ndërsa stafi teknik ka nisur përgatitjet për ndeshjen e parë, e cila do të jetë me ekipin më të fortë të grupit që është Anglia. Shorti ka rezervuar edhe një përballje tjetër pak ditë më vonë, ku Andorra do të udhëtojë për në Tiranë. Gjithsesi, përpos forcës së Anglisë, asgjë nuk është e pamundur. Nga ana tjetër, Silvinjo po bën llogaritë për lojtarët që do të grumbullojë për këto dy ndeshje. Këtu nisin edhe dilemat për Armando Brojën. Sulmuesi është duke u rikuperuar nga një dëmtim dhe koha e rikthimit është ulur. Nëse më parë prania e tij në Kombëtare mbetej në dyshim, me raportimet e fundit, thuhet se Broja pritet të rikthehet në javën e parë të muajit mars. Kjo do të ishte diçka shumë e rëndësishme për ekipin kombëtar, sidomos nëse sulmuesi do të ishte gati për lojë, por gjithçka do të shihet ato dy javë, nëse 23-vjeçari do të marrë minuta me klubin e tij përpara ndeshjeve të Kombëtares apo jo.

Gjyqtari që e ndëshkoi Bellinghamin, pezullohet përkohësisht nga futbollit

Gjyqtari spanjoll i futbollit, Munuera Montero, është pezulluar përkohësisht nga gjykimi i ndeshjeve në Spanjë dhe në garat evropiane për shkak të dyshimeve për një lidhje të tij me “Talentus Sport”, një kompani që ka marrëdhënie me disa klube të futbollit, përfshirë Atletico Madridin. Federata dhe autoritetet përkatëse duan ta hetojnë dhe sqarojnë këtë çështje për të shmangur çdo lloj të konfliktit të mundshëm të interesit dhe ndikimit e mundshëm në garë, shkruajnë mediet spanjolle. Deri në përfundim të hetimeve ai nuk do të caktohet si gjyqtar në asnjë ndeshje, mirëpo gjyqtari spanjoll insiston se kompania në të cilën bën pjesë, nuk ndikon në punën e tij si gjyqtar.

PSG-ja, 80 milionë euro për Camavingan

Paris Saint-Germain thuhet se dëshiron ta forcojë mesfushën dhe ka vënë syrin te ylli i Real Madridit, Eduardo Camavinga. Sipas mediumit “Fichajes”, klubi francez po përgatit një ofertë prej 80 milionë eurosh për ta nënshkruar atë nga Real Madridi këtë verë. PSG-ja e sheh Camavinga si një përforcim kyç, veçanërisht me Fabian Ruiz që mund të largohet. Luis Enrique beson se mesfushori francez do të sillte energji dhe ekuilibër në skuadrën e tij nga sezoni i ardhshëm. Camavinga mbetet i rëndësishëm për Real Madridin, por nuk ka qenë gjithmonë një titullar i rregullt nën drejtimin e Carlo Ancelottit. Konkurrenca e fortë në mesfushë ia ka kufizuar kohën e lojës. Mbetet për t'u parë nëse Real Madridi do ta konsiderojë shitjen e tij. Camavinga ka kontratë deri në vitin 2027 dhe më parë ka deklaruar se është i lumtur në klub.

Felix: I zhgënjyer nga eliminimi, doja të luaja më gjatë në Ligën e Kampioneve

Te Milani janë ende të zhgënjyer për eliminimin nga Liga e Kampioneve. Barazimi 1-1 ndaj Feyernordit në “San Siro” nuk ishte rezultati që kuqezinjtë prisnin, aq më tepër

kur udhëhiqnin pas golit të shënuar që në minutën e parë. “Ka shumë zhgënjim te të gjithë ne. Edhe në nivel personal doja shumë të luaja në Ligën e Kampioneve me

Milanin, por në vend të kësaj luajta vetëm dy ndeshje”, u shpreh sulmuesi portugez Joao Felix. Më tej, lojtari i ardhur në huazim nga Chelsea në merkaton e janarit shtoi: “Ky

është futbollit. Ne të gjithë duhet të mësojmë nga kjo ndeshje, nga ky eliminim, të rinj dhe të vjetër”. “Ne po kontrollojmë lojën dhe ishim gati ta shënonim golin e dytë.

Ata kurrë nuk kishin krijuar ndonjë rrezik në portën tonë. Pastaj, pas daljes së Theo Hernandezit me të kuq ndeshja ishte krejtësisht ndryshe”, ka shtuar Joao Felix.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Ecoimpex” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810495376 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da društvo sa “Ecoimpex” D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810495376 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Ecoimpex” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 810495376 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Adresa: rr.Ibrahim Krasniqi Prishtinë lurnshpk@gmail.com Nr tel: 045510011&46 143401&45 690 141

Prishtinë, 13.02.2025

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „LURN“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 810084062 me adresë: Rr. „Ibrahim Krasniqi“ nr. 10, Komuna e Prishtinës Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 13.01.2025 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej **483.12 kW** ZK Shajkoc, Komuna e Podujevës, Republika e Kosovës.

Shoqëria „LURN“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej **483.12 kW** ZK Shajkoc, Komuna e Podujevës, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.3861-2/23 dt. 23.10.2023 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Njoftimi nr. 07-350/02-0032027/23 dt. 10.05.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Vendimi për Kushte Ndërtimore Nr. 07-0350/04-0085583/23 dt. 12.02.2024 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Numri i vrojtimit të lejes: Nr. 07-351/02-0044941/24 të datës 29.11.2024 për “Ndërtimin e Parkut të Energjisë Solare Fotovoltaike me kapacitet prej 483.12 kW, ZK Shajkoc, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Podujevës.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 19358 dt.20.10.2024 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Deklarimet financiare;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit
- Kontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC)
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut. Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: lurnshpk@gmail.com dhe LEGAL-LENCING@ero-ks.org Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Agim Selloviq nga Ulqini Mali i Zi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II të Gjinnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Njomza Kadrija nga Peja shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m.l.m. “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Selmon Thaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme nr. Unik Identifikues të biznesit me nr. 810120684.

- Mërgim Uka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh,m,t “Nexhmedin Nixha” A. Mekanik.

- Rizo Hodaj nga Kabashi KK Prizren shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.a.t. “Abdyl Frashëri” Prishtinë Bukëpjekës.

- Dulë Gjurar Gerqinë KK Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-8.

- “Aroni DF” SH.P.K. shpall të pavlefshme numrin unik identifikues të biznesit 812228824 lëshuar nga ARBK.

Armir Krasniqi nga Demjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Kongresi i Manastirit” Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-5 dhe –6-9

- Valon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Arlinda Kalimashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjinnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

Albert Mehmeti nga Brovina kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I të Gjinnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë paralele e ndarë në Ponoshec.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

